

Emri i Lëndës : Makroekonomi							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
CMP 214	C	Pranverë	2.00	0.00	2.00	3.00	6.00
Lektori		Roland Çinari, Msc					
Asistenti		Gentjan Gegaj, Msc					
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Bachelor					
Përshkrimi		Konceptet thelbësore të ekonomisë dhe operimi i ekonomisë në shkallë kombëtare. Prodhimi, shpërndarja dhe konsumimi i të mirave dhe shërbimeve, roli i qeverisë, të ardhurat kombëtare dhe shpërndarja e tyre. Kursi paraqet teorinë e luhatjeve ekonomike afat-shkurtra që ofron bazën për kuptimin e shumicës së diskutimeve të politikës monetare dhe fiskale. Gjithashtu kursi u jep vëmendje të gjerë temave afat-gjata, duke përfshirë rritjen ekonomike, normën natyrore të papunësisë, inflacionin e vazhdueshëm dhe borxhin qeveritar. Temat përfshijnë ofertën për para dhe kërkesën për para, ekonominë e hapur, teorinë e luhatjeve ekonomike dhe debatet rreth çështjeve të ndryshme makroekonomike					
Objektivat		Objektivi i klasës Macro Economics është të prezantojë studentët me konceptet dhe teoritë themelore të makroekonomisë dhe t'i pajisë ata me mjetet për të kuptuar dhe analizuar çështjet dhe politikat makroekonomike. Deri në fund të kursit, studentët do të kenë një kuptim të fortë të variablave kryesore makroekonomike, të tilla si GDP, inflacioni, papunësia dhe normat e interesit dhe do të jenë në gjendje të shpjegojnë se si maten, si ndërveprojnë dhe si ndikohen nga politikat makroekonomike. Përveç kësaj, studentët do të zhvillojnë aftësinë për të aplikuar teorinë makroekonomike ndaj problemeve të botës reale dhe për të vlerësuar efektshmërinë e politikave të ndryshme makroekonomike në arritjen e objektivave makroekonomike.					
Konceptet Kryesore		1. GDP 2. inflacioni 3. avantazhet konkurrese 4. oferta dhe kërkesa 5. modeli IS-LM 6. papunësia. 7. buxheti qeveritar 8. konsumi dhe kursimi					
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Leksioni 1 – Parimet Bazë -Cila është diferenca midis mikroekonomisë dhe makroekonomisë? - Zgjedhjet bazë të vendim-marrjes makroekonomike: çfarë, si dhe për kë të prodhosh? - Pjesëmarrësit në ekonominë e tregut. -Konceptet bazë të përdorura në analizat ekonomike. - Sistemet ekonomike.						
2	Leksioni 2 – Tregëtia dhe Kompromiset -Përcaktimi i burimeve të përdorura në prodhimin e të mirave dhe shërbimeve. -Frontieri i mundësisë prodhuese. -Eficenca produktive. -Avantazhet konkurrese dhe përfitimet nga tregëtia. -Rrjedhja qarkulluese e të ardhurave, produkteve dhe shërbimeve në një ekonomi.						
3	Leksioni 3 – Oferta dhe Kërkesa -Tregjet e prodhimit dhe të burimeve. -Kërkesa konsumatore dhe “ligji i kërkesës”, ndryshimi i kërkesës, zhvendosja e kërkesës, faktorët që e ndryshojnë. -Oferta dhe “ligji i ofertës”, ndryshimi i ofertës, zhvendosja e ofertës dhe faktorët që e ndryshojnë.						
4	Leksioni 4- Makroekonomia-Piktura e Plotë -Ciklet e biznesit në ekonominë e tregut. - Komponentët e kërkesës agregate dhe të ofertës agregate. -Zhvendosja e krubave AD dhe AS. - Bazat e makroekonomisë. -Ekonomia klasike dhe neoklasike. -Jofleksibiliteti i pagave dhe i cmimeve. -Shqetësime rreth inflacionit.						
5	Leksioni 5 – Arritja e Makroekonomisë -Prodhimi i Brendshëm Bruto, matja e prodhimit të një ekonomie. -Sektori shtetëror. -Sektori financiar dhe ndërmjetësuesit e sketorit. -Tre tregjet: tregu i të mirave dhe shërbimeve, tregu i punës dhe tregu i parasë. -GDP reale dhe GDP nominale. - Metodat e matjes së GDP -Çfarë nuk përfshihet në GDP?						

6	Leksioni 6- Papunësia dhe Inflacioni -Si përcaktohet forca punëtore, cfarë është ajo? -Matja e papunësisë dhe e punësimit. -Llojet e papunësisë. -Raporti i pjesëmarrjes së forcës punëtore. - Papunësia dhe dryshimet në ekonominë globale.
7	Përsëritje dhe Diskutime
8	Provimi gjysmë final
9	Leksioni 7 - Matja e Inflacionit -Cfarë tregon inflacioni për ekonominë e një vendi? -Të ardhurat reale kundrejt të ardhurave nominale. -Normat reale të interesit dhe normat nominale të interesit. -Kostot dhe efektet e inflacionit.
10	Leksioni 8 - Politika Fiskale -Përcaktimi i politikës fiskale; taksimi dhe shpenzimet për të arritur objektivat makroekonomike. -Shpenzimet qeveritare dhe taksimi. -Stabilizatorët automatik: taksa e të ardhurave, sigurimi i papunësisë. -Politika e taksave dhe shpenzimeve diskrecionare. -Deficiti dhe teprica buxhetore.
11	Leksioni 9 - Paraja, Banka dhe Sistemi i Rezervave Kombëtare. -Cfarë është para? -Nivelet e matjes së ofertës monetare M1 dhe M2. -Roli monetar i bankave.
12	Leksioni 10 - Politika Monetare -Struktura e sistemit të rezervave kombëtare. -Si e rregullon banka qendrore ofertën e parasë. -Fondet federale. -Roli i kredive, debive dhe parave elektronike në ofertën e parasë. -Roli i ndërmjetësuesve financiar.
13	Leksion i Hapur - Sugjerim filmi "Too big to fail" ose, "Inside Job"
14	Leksioni 11 - Tregëtia Ndërkombëtare -Historia e marrëveshjeve tregëtare. -Deficiti dhe teprica tregëtare. -Avantazhet konkurruese dhe tregëtia. -Normat e shkëmbimit valutor. -Dimensionet e globalizimit.
15	Përsëritje
16	Provim Final
Parakushtet Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.	
Literatura • Makroekonomia; Leksione perkthyer dhe pershtatur nga Dornbuch & S. Fischer Macroeconomis, Prof. Dr. sulo Haderi, 2012. Makroekonomia, R.Dornbusch, S. Fischer, Botimi 6, Dituria N. Gregory Mankiw, Macroeconomics, Sixth Ed., 2007, Worth Publishers.	
Referenca të tjera • Materiale te ndryshme studimore shkencore te cilat do te perftohen nga lektori nepermjet webpges ose te printuara.	
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Kuptueshmëri dhe kompetencë në përdorimin e terminologjisë makroekonomike
2	Kuptueshmëri e funksionimit të bazave të ekonomisë dhe kompetencë në mënyrën se si ato funksionojnë në nivel agregatë.
3	Njohje e lidhjeve midis variablave makroekonomike .
4	Aftësim në të lexuarit dhe interpretuarit e informacionit empiric tek të dhënat makroekonomike, grafiqet e paraqitura, tabelat, etj.
5	Analizimi i burimit të prosperitetit afatgjatë dhe i faktorëve kontribues në rritjen afat-gjate ekonomike.
6	Analizimi dhe kuptimi i luhatjeve afat-shkurtëra ekonomike dhe fitimi i kompetencës në mekanizmat e përdorura për të stabilizuar ekonominë, për të arritur punësim të plotë dhe inflacion të ulët.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	40	
Kuize	0	0	
Projekte	0	0	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	0	0	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			40
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			60
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	4	64
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	4	56
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	14	14
Provimi final	1	16	16
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			150
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			6.00
ECTS			6.00